

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË AKTIVITETIN KUNDËR
KORRUPSIONIT, NË FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**
7 dhjetor

Dekan Kaçupi,
Drejtor Llalla,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

Jam shumë i gëzuar që jam me ju sot për të shënuar Ditën Ndërkombëtare Kundër Korruptionit.

Ndërsa jam këtu me ju, me gjyqtarët, prokurorët, juristët dhe zyrtarët e ardhshëm të administratës publike, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen ndaj plagës djallëzore të korruptionit.

Ditën Ndërkombëtare kundër Korruptionit e shoh qartë si një mundësi të rëndësishme për të theksuar ndikimin shkatërrues që mund të ketë korruptioni tek shoqëria dhe individit. Po me të njëjtën qartësi dhe shumë më tepër pozitivisht shoh edhe rëndësinë dhe rolin që mund të luajë angazhimi juaj për integritet dhe sjellje etike gjatë vazhdimin të karrierave tuaja.

Me ndikimin e saj të drejtpërdrejtë te stabiliteti ekonomik dhe social, lufta kundër korruptionit përbën një përparësi kryesore për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, që zë vend në mandatin e saj aktual.

Ne mbështesim – si institucionet vendase ashtu edhe shoqërinë civile – në promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe në marrjen e masave të tjera për të luftuar korruptionin.

Duhet të përmend këtu në mënyrë të veçantë bashkëpunimin e shkëlqyer me ILDKP-në, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për shumë vite me radhë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështje që lidhen me konfliktin e interesit.

Le të jemi të qartë, sa herë dhe kurdoherë që zë rrënjë, korruptioni sjell pasoja mbi çdo nivel të shoqërisë.

Korruptioni shkatërron ekonominë, cenon stabilitetin social dhe shkatërron besimin e publikut.

Korruptioni ul të ardhurat nga tatimet, krijon inflacion për shërbimet vendore, deformon konkurrencën private dhe mund të dënojë grupet e dobëta me varfëri.

Përfundimisht, korruptioni mund të çojë në një mungesë të konsiderueshme stabiliteti dhe madje edhe në konflikte të dhunshme.

Të gjithë ne e dimë nga raportet e shumta ndërkombëtare tashmë të botuara se korruptioni mbetet dominues në shumë sektorë megjithë marrjen e shumë masave të lavdërueshme parandaluese.

Mungesa e transparencës dhe baza e paqartë ligjore për të përforcuar të drejtën e pronës përbëjnë një fushë që lehtësojnë korrupsionin dhe dëmtojnë më tej qëllimin e krijimit të një tregu funksional të pronave të paluajtshme.

Angazhimi i qartë i autoriteteve për të luftuar korrupsionin nuk është pasuar gjithmonë nga një zbatim konsekuent i ligjeve ekzistuese.

Duhet të krijohet një regjistër më bindës dhe më i qëndrueshëm i historikut të vendimeve të gjykatës dhe të ndiqet një politikë më e ashpër dënimesh dhe/ose gjobash në rastet e korrupsionit, sidomos në ato raste ku përfshihen zyrtarë të lartë.

Përveç kësaj, trajtimi i vendosur dhe transparent i rasteve që lidhen me akuza për korrupsion, pavarësisht statusit të të akuzuarve mbetet një tregues kyç i pavarësisë gjyqësore.

Mund të shtoj se imuniteti i plotë i zyrtarëve të lartë publikë, duke përfshirë edhe gjyqtarët, mbetet pengesë kryesore për një hetim efikas dhe të suksesshëm.

Ky imunitet, së bashku me mungesën e një qasjeje pro-aktive në ndjekjen e çështjeve dhe mungesa e burimeve nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, vazhdon të pengojë seriozisht hetimin efikas.

Përvoja në vende të tjera ka treguar se midis niveleve të larta të korrupsionit dhe niveleve të ulëta të angazhimit të shoqërisë civile ka një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore.

Megjithëse OJQ-të kanë bërë progres vitet e fundit në përfshirjen në luftën kundër korrupsionit, përpjekjet e tyre mbeten ende të dobëta, të fragmentuara dhe të paqëndrueshme.

Prandaj, është e rëndësishme të shihet një pjesëmarrje më aktive në monitorimin e veprimtarive qeveritare me qëllim promovimin e një transparence dhe përgjegjshmërie më të madhe.

Nuk duhet harruar rëndësia e medias së lirë si një mjet vendimtar për arritjen e një përgjegjshmërie më të madhe në proceset publike vendim-marrëse.

Një media e lirë duhet të shërbejë si një kundërpeshë ndaj korrupsionit, duke mos harruar kurrë përgjegjësitë e saj për të raportuar *faktet* dhe për të marrë përsipër rolin e *gjyqtarit apo jurisë*.

Është gjithashtu e rëndësishme që të forcohet më tej një administratë etike, profesionale dhe e paanshme, një administratë që mbështetet tek procedurat dhe që garanton një punësim të drejtë, shpërblim të përshtatshëm dhe një zhvillim karriere të bazuar tek merita dhe rezultatet në punë.

Megjithatë, ne duhet ta kemi të qartë se qeveria nuk mund ta adresojë e vetme korrupsionin.

Prandaj edhe media, shoqëria civile dhe publiku i gjerë duhet t'i mbështesë në mënyrë aktive institucionet si ILDKP-në kundër korrupsionit, kur përballlet me dyshime për korrupsion.

Do të ishte turp nëse gjithë ky proces madhor që ka bërë Shqipëria në reformat sociale, politike dhe ekonomike deri më sot do të merrte një goditje nga paaftësia apo mungesa e vullnetit për të adresuar shkaqet themelore të korrupsionit dhe do të vononte kështu zhvillimin aq shumë të nevojshëm për këtë vend kaq të mrekullueshëm.

Drejtori Llalla,
Dekan Kaçupi,
Zonja dhe zotërinj,

Për këtë arsye, do të doja t'ju ftoja që të mos humbim kohë, por menjëherë të kapim çastin!

Dëshiroj, gjithashtu, t'ju inkurajoj që të jepni kontributin tuaj për ta ndihuar vendin tuaj që të arrijë nivele më të larta transparencë dhe një qeverisje më të përgjegjshme.

Sic ka thënë dikur edhe qytetarja e njohur amerikane znj. Bess Myerson "*Bashkëpunëtori më i madh i krimit të korrupsionit është shpesh vetë indiferenca jonë*".

Ju faleminderit për vëmendjen tonë.

Fund